

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Vendi i furnizmit të shërbimeve

Vendi i furnizimit të shërbimeve

- **Rregulli i përgjithshëm- Neni 24.**

1. Marrësi i shërbimit, person i tatueshëm. (Në vendin e konsumatorit)

Vendi i furnizimit të shërbimit është në Shqipëri nëse marrësi i shërbimit, një person i tatueshëm që sillet si i tillë, ka në Shqipëri:

- *selinë e veprimtarisë së tij ekonomike ose një vendndodhje të qëndrueshme për të cilën janë kryer shërbimet*
- *banesën ose rezidencën e zakonshme, në mungesë të një selie të veprimtarisë ekonomike apo të një vendndodhjeje të qëndrueshme.*

2. Marrësi i shërbimit, person i patatueshëm (Në vendin e furnizuesit)


Vendi i furnizimit të shërbimit është në Shqipërisë, nëse marrësi i shërbimit është një person i patatueshëm ndërsa furnizuesi, person i tatueshëm, ka në Shqipëri:

- *selinë e veprimtarisë së tij ekonomike ose një vendndodhje të qëndrueshme, nga e cila janë ofruar shërbimet*
- *banesën ose rezidencën e zakonshme, në mungesë të një selie të veprimtarisë ekonomike apo të një vendndodhjeje të qëndrueshme*

Vendi i furnizimit të shërbimeve

- Skema


Rregulli i përgjithshëm - Marresi i shërbimit, person i tatueshëm në Shqipëri - Neni 24.1



Vendi i furnizimit të shërbimeve

- Skema

Rregulli i përgjithshëm- Marrësi i shërbimit, person i tatueshëm jo në Shqipëri - Neni 24.1



Vendi i furnizimit të shërbimeve

- Skema

Rregulli i përgjithshëm - Marrësi i shërbimit, person i patatueshëm - Neni 24.2

Jashtë Shqipërisë

Konsumatori person i
patatueshëm

Shqipëri

Furnizim shërbimi

Furnizuesi person i
tatueshëm

Faturë me TVSH -
sipas legjislacionit
shqiptarë

Vendi i furnizimit të shërbimeve

- ❑ Kur shërbimi i furnizohet :
 - një vendndodhje të qëndrueshme të marrësit (dege), e cila ndodhet në Shqipëri ndërkohë që,
 - selia e shoqërisë ndodhet jashtë Shqipërisë (p.sh. në Kosovë),
 - furnizimi tatohet atje ku ndodhet vendndodhja e qëndrueshme, pra në Shqipëri.

A. Marrësi i shërbimit jashtë Shqipërisë

- ❑ Kur vendi i tatimit është në vendin e marrësit të shërbimit dhe marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm jashtë Shqipërisë, atëherë shërbimi nuk tatohet me TVSH-në në Shqipëri.
- ❑ Në faturën e TVSH-së të lëshuar nga furnizuesi, nuk llogaritet TVSH, pasi ky shërbim nuk është objekt i aplikimit të tatimit në Shqipëri.
- ❑ Në faturë duhet të shënohet neni i ligjit, të cilit i referohet trajtimi i shërbimit pa TVSH.
 - *Është kusht që të jepet përshkrimi i plotë i shërbimit në faturë.*

Vendi i furnizimit të shërbimeve

- ❑ Në çdo rast kur marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm i TVSH-së jashtë Shqipërisë, furnizuesi një person i tatueshëm i vendosur në Shqipëri, duhet të marrë dhe disponojë informacionet e nevojshme nga marrësi i shërbimit, që të provojë mostaksimin.
- Dokumentacioni i nevojshëm është:
 - Kontrata për shërbimin;
 - Vërtetim nga autoritetet tatimore të vendit të marrësit të shërbimit ku të shprehet qartë që personi i tatueshëm është i regjistruar për TVSH;
 - Elementet e pagesës së faturës së shërbimit nëpërmjet llogarisë;
 - Në faturë duhet të jepet përshkrimi i plotë i shërbimit të kryer dhe të shënohet neni i ligjit, të cilit i referohet trajtimi i shërbimit.
 - Furnizuesi ngarkohet të mbledhë çdo element tjetër që vërteton se marrësi i furnizimit të shërbimit vepron si person i tatueshëm

Vendi i furnizimit të shërbimeve

- Kur furnizuesi i shërbimit një person i tatueshëm i vendosur në Shqipëri, nuk është në gjendje të vërtetojë sa më sipër, atëherë vendi i furnizimit të shërbimit është në vendin e furnizuesit të shërbimit në Shqipëri.

B. Marrësi i shërbimit në Shqipëri.

- Kur marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm i vendosur në Shqipëri për furnizimet e shërbimit të marra jashtë Shqipërisë vendi i furnizimit të të cilave është në vendin e marrësit të shërbimit, vendi i tatimit është në Shqipëri.
- *Për këtë marrësi i shërbimit lëshon një faturë tatimore në të cilën do të llogarisë TVSH-në mbi vlerën totale të faturës së marrë nga furnizuesi i shërbimit.*
- *Fatura duhet të përpilohet sipas kërkesave të nenit 101 të ligjit dhe në të duhet të evidentohet dukshëm shënimi , “Auto-ngarkesë e TVSH-së reverse charge”.*

Tabelë përmbledhëse - Përjashtime nga rregulli i përgjithshëm, pavarësisht statusit fiskal (person i tatueshëm apo jo) të konsumatorit - Neni 25

Natyra e shërbimit të kryer	Vendi i taksimit	Kushti përcaktimit të vendit të taksimit
Furnizimi i shërbimeve të lidhura me një pasuri të paluajtshme	Shqipëri	- Vendndodhja e pasurisë Nëse pasuria e paluajtshme ndodhet në Shqipëri
Furnizimi i shërbimeve të transportit të pasagjerëve	Shqipëri	- Distanca e përshkruar Proporcionalisht me distancën e përshkruar në Shqipëri
Furnizimi i shërbimeve të restorantit dhe shërbimeve të furnizimit me ushqim	Shqipëri	- Kryerja efektive e shërbimit Kur shërbimet kryhen fizikisht në Shqipëri
Furnizimi i shërbimeve të restorantit dhe shërbimeve të furnizimit me ushqim, në bord, gjatë transportit të pasagjerëve	Shqipëri	- Nga nisjet transporti fillimisht Nëse vendi i nisjes së transportit është në Shqipëri
Furnizimi i shërbimit të dhënies me qira afatshkurtër të një mjete transporti	Shqipëri	- Ku vihet në dispozicion mjete Nëse mjete, vihet në dispozicion të klientit në Shqipëri

Tabelë përmbledhëse - Përjashtime nga rregulli për shërbime kundrejt personave të tatueshëm - Neni 26

Natyra e shërbimit të kryer	Vendi i taksimit	Kushti përcaktimit të vendit të taksimit
Ngjarjeve kulturore, artistike, sportive, shkencore, edukative, zbavitëse apo të ngjashmeme këto, si ekspozita dhe panaire	Shqipëri	Nëse këto aktivitete zhvillohen në Shqipëri
Shërbime mbështetëse, të lidhura me pranimin në këto aktivitete	Shqipëri	Nëse këto aktivitete zhvillohen në Shqipëri

Tabelë përmbledhëse - Përjashtimi nga rregulli për shërbimet e furnizuara nga ndërmjetësi, për personin e patatueshëm - Neni 27

Natyra e shërbimit të kryer	Vendi i taksimit	Kushti përcaktimit të vendit të taksimit
Furnizimi i shërbimit të kryer nga një person ndërmjetës, që vepron në emër dhe për llogari të një personi tjetër.	Shqipëri	Nëse vendi i transaksionit kryesor, është në Shqipëri

Tabelë përmbledhëse - Përjashtime nga rregulli për shërbime kundrejt personave të patatueshëm - Neni 28

Natyra e shërbimit të kryer	Vendi i taksimit	Kushti përcaktimit të vendit të taksimit
Furnizimi i shërbimit të transportit të mallrave	Shqipëri	Proporcionalisht me distancën e përshkruar në Shqipëri
Furnizimi i shërbimeve si dhe shërbimeve mbështetëse për qëllim të aktiviteteve kulturore, artistike, sportive, shkencore, edukative, zbavitëse apo aktiviteteve të ngjashme, të tilla si panairot dhe ekspozitat, përfshirë furnizimin e shërbimeve të organizatorëve të këtyre aktiviteteve	Shqipëri	Nëse kryhen këto aktivitete në Shqipëri
Furnizimi i shërbimeve mbështetëse të transportit, si ngarkim, shkarkim, mirëmbajtje dhe aktivitete të ngjashme	Shqipëri	Nëse këto shërbime janë kryer fizikisht në Shqipëri
Furnizimi i shërbimeve të ekspertizave ose punëve të kryera mbi pasurinë e luajtshme	Shqipëri	Nëse këto shërbime janë kryer fizikisht në Shqipëri
Furnizimi i shërbimit të dhënies me qira të një mjeti transporti, përjashtuar atë afatshkurtër. *Me “afatshkurtër” - një periudhë kohore jo më shumë se tridhjetë ditë dhe në rastin e mjeteve lundruese, jo më shumë se nëntëdhjetë ditë	Shqipëri	Nëse klienti është i vendosur, ka adresën e përhershme ose banon zakonisht në Shqipëri

Tabelë përmbledhëse - Furnizimi i shërbimeve të telekomunikacionit, të transmetimit dhe shërbimeve elektronike ndaj personave të patatueshëm - Neni 29

Natyra e shërbimit të kryer	Vendi i taksimit	Kushti përcaktimit të vendit të taksimit
Furnizimi i shërbimeve të telekomunikacionit	Shqipëri	Nëse vendi i klientit, person i patatueshëm është në Shqipëri
Furnizimi i shërbimeve të transmetimit të radios dhe ato televizive	Shqipëri	Nëse vendi i klientit, person i patatueshëm është në Shqipëri
Furnizimi i website-ve, web-hosting, mirëmbajtjes në distancë të programeve dhe pajisjeve	Shqipëri	Nëse vendi i klientit, person i patatueshëm është në Shqipëri
Furnizimi me software dhe përditësimi i tyre	Shqipëri	Nëse vendi i klientit, person i patatueshëm është në Shqipëri
Furnizimi i imazheve, teksteve , informacioneve e vlefshmëria e bazës të të dhënave (database)	Shqipëri	Nëse vendi i klientit, person i patatueshëm është në Shqipëri
Furnizimi me muzikë, filma dhe lojëra, përfshirë lojërat e fatit dhe bastet, si dhe transmetimet e ngjarjeve politike, kulturore, artistike, sportive, shkencore dhe argëtuese	Shqipëri	Nëse vendi i klientit, person i patatueshëm është në Shqipëri
Furnizimi i shërbimit të mësimdhënies në distancë	Shqipëri	Nëse vendi i klientit, person i patatueshëm është në Shqipëri

Tabela përmbledhëse - Furnizimi i shërbimeve ndaj personave të patatueshëm në Shqipëri - Neni 30

Natyra e shërbimit të kryer	Vendi i taksimit	Kushti përcaktimit të vendit të taksimit
Transferimet dhe dhënia e të drejtave të autorit, patentave, licencave, markës tregtare dhe të drejtave të tjera të ngjashme;	Shqipëri	Nëse vendi i klientit, person i patatueshëm është në Shqipëri
Shërbime publiciteti	Shqipëri	Nëse vendi i klientit, person i patatueshëm është në Shqipëri
Shërbimet e konsulentëve, inxhinierëve, firmave konsulente, avokatëve, kontabilistëve dhe shërbime të tjera të ngjashme, si dhe përpunimi i të dhënave dhe dhënia e informacionit	Shqipëri	Nëse vendi i klientit, person i patatueshëm është në Shqipëri
Detyrimet për të mos ushtruar, pjesërisht ose tërësisht, një aktivitet tregtar apo një të drejtë	Shqipëri	Nëse vendi i klientit, person i patatueshëm është në Shqipëri
Transaksionet bankare, financiare dhe të sigurimit, ku përfshihet edhe risigurimi, me përjashtim të marrjes me qira të kasafortave	Shqipëri	Nëse vendi i klientit, person i patatueshëm është në Shqipëri
Furnizimi me personel	Shqipëri	Nëse vendi i klientit, person i patatueshëm është në Shqipëri
Dhënia me qira e pasurive materiale të luajtshme, me përjashtim të të gjitha mjeteve të transportit	Shqipëri	Nëse vendi i klientit, person i patatueshëm është në Shqipëri
Shërbimi i lejimit në sistemin e gazit natyror ose në çdo lloj rrjeti të lidhur me një sistem të tillë, në sistemin e elektricitetit ose rrjeteve të ngrohje-ftohjes, ose transmetimi apo shpërndarja përmes këtyre sistemeve a rrjeteve dhe furnizimi i shërbimeve që lidhen direkt me to.	Shqipëri	Nëse vendi i klientit, person i patatueshëm është në Shqipëri